

V E N D I M
Nr. 719, datë 21.12.2000

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.129, DATË 18.3.1999, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E
LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 dhe 21, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 7, të vendimit nr.129, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, pas paragrafit III, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kushti i kapacitetit minimal të depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse e të kalibrimit të tyre, duhet të plotësohen nga subjektet, që kryejnë veprimtarinë e tregtimit të gazit të lëngshëm, sipas nenit 14, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, deri më datë 31.12.2001. Me plotësimin e këtyre kushteve jepet leja e tregtimit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta